



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

Nr.17( 61012-00155-53-2019) Regj. Themeltar  
Data e regj. 23.01.2019.

Nr 17 Vendimit  
Datë 23.01.2019.

VENDIM

“PËR CAKTIM MASE SIGURIMI PASUROR”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e përbërë prej:

**GJYQTAR - ARTAN HAJREDINAJ**

Asistuar nga sekretare Diella Ndoci, sot në datë 23.01.2019 ora 9.30, në Lezhë, shqyrtoi në seancë gjyqësore çeshtjen penale me Nr. 17 Akti që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, përfaqësuar nga prokuror Erjon Shehaj.

OBJEKT:

Vendosjen e sekuestros preventive mbi;

- a. Llogarite, transaksionet bankare dhe çdo depozite në emër dhe për llogari të shtetasve; P. V , i biri i N dhe D i datëlindjes , me ID nr. D , lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh. P , e bija e P dhe P , e datelindjes , me ID nr. ( , lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.
- b. Pasuritë e paluajtshme duke urdheruar sekuestrimin e tyre ne Zyren Vendore te Regjistrimit te pasurive te Paluajtshme Lezhe, ashtu dhe ne gjendjen faktike ne te cilen ndodhen sot në pronësi të shtetasve; P. V , i biri i N dhe D , i datëlindjes ( lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh. P , e bija e P dhe P , e datelindjes : lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.

BAZA LIGJORE:

Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, në përfundim të gjykimit të zhvilluar, pas administrimit të provave, në prani të prokurorit, i cili kërkoi sipas objektit, si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi, e analizoi kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasuror, vendosjes së sekuestros preventive;

### VEREN SE:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë mbi bazën e kallëzimit penal të referuar nga Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, me shkresën nr. 49 prot, datë 22.01.2019, në datë 22.01.2019 ka regjistruar proçedimin penal nr. 57 viti 2019 për veprën penale të “*Pastrimi i produkteve të vepres penale*” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Gjykimi i kërkesës me objekt vendosje e sekuestros preventive u zhvillua në bazë aktesh, pa u dëgjuar pala tjetër, duke i lënë vend kontradiktoritetit të palëve për t’u zhvilluar, në rast ushtrimi të ankimit, në shkallë të dytë, bazuar në qëllimin e parashikimit në nenin 274/1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me rrezikun e vonësës (si element i sekuestros preventive) dhe në përputhje me nenin 276/2 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon paraqitjen e ankimit nga personi i interesuar pas marrjes dijeni për sekuestron e vënë.

Me datë 22.01.2019 Drejtoria Vendore e Policise Lezhe me shkresën Nr. 49 prot ka referuar kallzimin penal në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhe për veprën penale të “*Pastrimi i produkteve të vepres penale*” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal. Sipas kallzimit penal të referuar nga Drejtoria Vendore e Policise Lezhe ka rezultuar se;

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, i ndryshuar, nga verifikimet e kryera në databazin, për raportimet e transaksioneve të vlerave, në emër të shtetasve Pj Ni V dhe Sh P P dhe familjarët e tyre, kanë rezultuar transaksione në vlera të konsiderueshme dhe me anomali si më poshtë:

Transaksione bankare; Për periudhën korrik janar 2019, rezultuan transaksione në vlera domethënëse kryesisht në “Banka Kombëtare Tregtare” në emër të ketyre dy shtetasve.

Raportime të tjera në emër të: S al Kontrata noteriale, Në datë 14.09.2018, S P: ka porositur blerjen e tre apartamenteve dhe 3 post-parkimeve në Tiranë, nga F! H i me NUIS: L në vlerën e deklaruar prej 729 005 EUR, (vlera e apartamenteve 675 000 EUR dhe 54 000 EUR ajo e post-parkimeve).

Transaksione bankare; F i P. Në datë 09.08.2013, llogaria në “Raiffeisen Bank” i është debituar në shumën prej 37 000 EUR. Në datë 11.09.2013, llogaria në “Raiffeisen Bank” i është debituar në shumën prej 10 000 EUR.

i; Kontrata noteriale; Në datë 17.07.2015, ka blerë nga shoqëria “EURO ADRIATIC” apartamentin në vlerën e deklaruar prej 30 000 EUR. Në datë 22.06.2018 ka blerë një apartament nga A P, në vlerën e deklaruar prej 5 040 000 LEK.

A i Kontrata noteriale; Në datë 02.08.2013, ka nënshkruar një prokurë të posaçme në Zyren e Noterise Lezhe të noter V M: ku emëron përfaqësues të posaçëm për nënshkrimin e kontratës së shitjes së një apartamenti, shtetasin P i P.

Në datë 10.08.2013, ka blerë një pasuri të paluajtshme në vlerën 6 000 000 LEK, të noter V M. Në datë 14.08.2018, ka blerë një apartament nga shtetasi E P: i dtl 23.12.1965, në vlerën e deklaruar prej 8 750 000 LEK. Në datë 18.08.2016, së bashku me Si V: ka nënshkruar një prokurë të posaçme të noterit V M: ku është parashikuar se P: V: do

të përfaqësojë këta dy shtetas në nënshkrimin e kontratës së pjesëtimit të pasurive të paluajtshme të përfutur me ligjin nr.7501 si dhe nga trashëgimia e te ndjeres P V. Në datë 20.10.2016, ka blerë një pasuri të paluajtshme "apartament" në vlerën e deklaruar prej 34 000 EUR nga shtetasit S dhe S M. Në datë 14.08.2018, ka blerë 1 një apartament në vlerën e deklaruar 70 000 EUR, nga shtetasi E P. Në datë 14.09.2018, ka blerë nga shtetasit D dhe K M një apartament në Shëngjin në vlerën e deklaruar prej 80 000 EUR.

Per sa me sipër bazuar në nenin 11/ë të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar, është kërkuar informacion në "Banka Kombëtare Tregtare" lidhur me këta shtetas, nga ku ka rezultuar se:

Për periudhën 23.07.2018 e në vijim llogaria e shtetasesh Sh P në "Banka Kombëtare Tregtare" është kredituar nga 10 transfertat të dërguara nga Zvicra, nga një shtetas suedez me gjeneralitete; S A L në vlerën totale prej 1 419 626 EUR përshkruar si më poshtë:

Për periudhën 23.07.2018-29.08.2018 kanë mbërritur 5 transfertat në vlerën totale prej 1 184 838 EUR ku vetëm transfertat e parë përmbante qëllimin e dërgimit, atë të deklaruar si "shpenzime familjare" në vlerën prej 9 978 EUR, ndërkohë të tjerat nuk përmbanin asnjë element për përshkrimin e qëllimit të përdorimit të shumave të dërguara. Shtetasja Sh P ka rezultuar se ka bërë disa deklarata kontradiktore pranë BKT dhe konkretisht; Fondet në të vërtetë janë dhuruar nga shtetasi suedez me vendbanim në Zvicër, për shkak të marrëdhënieve të afërta të motrës së saj, A V, shtetase suedeze, me shtetasin suedez S A L, i cili është pronar i kompanisë "B A", (me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve të makinerive dhe mjeteve motorike) në të cilën shtetasja A V, punon si menaxhere, me qëllimin e përdorimit të tyre për blerjen e 3 apartamenteve nga dy motrat dhe vëllai i tyre shtetasi S V.

Fondet në fakt destinohen si dhuratë për motrën e saj A V e cila do t'i investojë në blerjen e pasurive të paluajtshme në Shëngjin. Konkretisht në këtë periudhë evidentohet se:

Në datë 30.07.2018, llogaria i është kredituar në shumën 9 978 EUR nga transfertat e shtetasit suedez S A Li me përshkrim "shpenzime spitalore". Në datë 31.07.2018 ka tërhequr në cash 9 975 EUR, ndërkohë lidhur me përdorimin e pjesës tjetër të fondeve të transferuara rezulton që: Në datë 01.08.2018, llogaria i është kredituar nga transfertat tjetër e shtetasit suedez S A Li në vlerën prej 24 950 EUR. Nga kjo shumë vlera prej 20 000 EUR ka kaluar në favor të noterit, V M pranë "Tirana Bank" dhe më vonë në datë 02.08.2018 ka tërhequr 4 800 EUR. Në datë 15.08.2018 dhe 29.08.2018, llogaria i është kredituar edhe nga dy transfertat të tjera, përkatësisht në vlerat 49 925 EUR dhe 29 945 EUR. Në datë 03.09.2018, këto fonde i ka kaluar në favor të noterit V M:

Sipas shtetasesh Sh P është deklaruar verbalisht se qëllimi për të dy pagesat në favor të noterit V M, do të ishte për "Blerje Apartamenti për A V" dhe "Likuidim, blerje pasurie e paluajtshme".

Në datë 30.08.2018, llogaria e saj është kredituar në shumën prej 1 069 925 EUR, e cila ka pasur vlerën më të konsiderueshme në raport me transfertat e mëparshme, përkatësisht pa asnjë detaj në rubrikën e "përshkrimi i transaksionit", prej të cilave 469 638 EUR janë vendosur në depozitë, 79 800 janë transferuar në favor të noterit V M dhe 600 000 EUR janë transferuar në favor të F H -PF. Për periudhën nëntor 2018 janar 2019, llogaria e saj është kredituar në shumën totale prej 234 788 EUR nën përshkrimet: "dhuratë për Krishtlindje, kompensim page, veshmbathje dimri, aksesori kuzhine" (49 900 EUR), "rikonstruktiv dhe ndihmë financiare" (94 875 EUR) "mbulimin e disa shpenzimeve spitalore për kurimin e të atit të saj"

(4 983 EUR), "blerje pajisjesh shtëpiake" (84 925 EUR). Nga kjo shumë totale, 94 900 EUR janë vendosur në depozitë, 4 983 EUR janë tërhequr.

Në datë 16.01.2019, P. V. ka çelur një llogari pranë BKT, arsyen e hapjes së cilës e ka deklaruar për qëllimin e përfitimit të disa fondeve nga shtetasi suedes S. A. L., të cilat do të përdoren për mbulimin e disa shpenzimeve spitalore të P. V. i cili deklaron se vuan nga një sëmundje veshkash.

Në datë 17.01.2018, ka mbërritur një transfertë nga Zvicra, në vlerë të konsiderueshme 3 849 925 EUR. Urdhëruesi i kësaj transferte është S. A. L. dhe përsa i përket qëllimit të saj, nga detajet e pagesës bëhet fjalë për një dhuratë "Gift to my dearest friend P. V.". Banka urdhëruese e transfertes është "BANQUE CANTONALE DU VALAIS" në Zvicër dhe banka korespondente është COMMERZBANK AG në Gjermani. Të dhenat identifikuese të transfertes në mbërritje janë si mëposhtë:

CU: .....  
20: .....  
23B: CRED  
32A: .....  
33B: EUR3850000,00  
50K: /  
50K: S  
50K: ROUTE DES ZIRES 19  
50K: 3963  
52A: 52A:  
52A: B. = BANQUE CANTONALE DU VALAIS  
59: /A  
59: PJ. L V  
59: LAGJIA SKENDERBEG  
59: 4501 LEZHE  
70: GIFT TO MY DEAREST FRIEND PJ

Lidhur me përfitimin e fondeve të konsideruara në emër të Sh. P. është kërkuar informacion pranë autoriteteve ligjore në Suedi dhe në Zvicër. Sipas autoriteteve ligjore në Suedi është konfirmuar që shtetasi S. A. L. ka biznese por nuk kanë më shumë të dhëna pasi transaksionet nuk kryen nëpërmes Suedisë. Nga autoritetet ligjore në Zvicër nuk është kthyer pergjigje dhe është kërkuar informacion perseri por ende nuk është kthyer pergjigje.

Prokuroria në kërkesë parashtron se nga teresia e provave të mbledhura gjatë hetimit të kësaj ceshtje penale rezultojnë se

#### **Pretendimet e prokurorisë:**

Nga hetimet e kryera rezultojnë se; Vlerat e transfertave në mbërritje janë të konsiderueshme dhe të pa-justifikuara. Mungojnë detajet mbi qëllimin e transferimit të këtyre fondeve si dhe ka mospërputhje që ekzistojnë ndërmjet informacioneve të dhëna në lidhje me arsyen e përfitimit të këtyre fondeve dhe përshkrimet të përcaktuara në mesazhin e Swiftit të transfertes së parë të mbërritura në llogarinë e Sh. P. "shpenzime spitalore". Mundësitë reale të përdorimit të fondeve të mbërritura në llogari të P. V. sikurse është deklaruar, për mbulimin e shpenzimeve spitalore (të cilat janë tepër të larta për çdo vend tjetër, përveçse në Shqipëri, situar këtu dhe moshën e shtetasit P. V., 83 vjeç, moshë e cila teorikisht është tepër e vështirë të përballojë ndërhyrje të tilla). Tjetërsimi i fondeve dhe investimi në pasuri të paluajtshme në

Shqipëri për llogari të personave të tretë (*jo-rezident*) është e paqartë pse Lindholm i transferon nga llogaria e tij personale tek llogaria e Shqipëri në Shqipëri. Maskimi i fondeve, duke bërë të mundur që përfituesi final të mos jetë Shqipëri dhe të afërmit e saj, por vetë dërguesi i këtyre fondeve S.A.L. Numri i lartë i transfertave të kryera brenda një periudhe të shkurtër kohe. Mungesa e një dokumentacioni që justifikon deklaratimet e Shqipëri në lidhje me pozicionin e larte menaxherial të motrës së saj A.V. në kompaninë "B.A.", linden dyshime se kemi të bëjmë me një skemë për të kryer pastrim të produkteve të veprës penale, dyshime mbi burimin e fondeve dhe aktivitetin e kryer, e për rrjedhojë Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit të Parave ka nxjerre Urdherin Nr 1765/21 date 21.01.2019, urdhër bllokimi me efekt 72 orë nga marrja dijani për Bankën Kombëtare Tregtare, për llogaritë transaksionet bankare në emër dhe për llogari të Pjetër N. V. i datëlindjes 01.07.1936 dhe Shqipëri P. e dtl 28.08.1969. Vlera totale e bllokuar nga D.P.P.P.P është: 5 269 551 EUR.

Për këto arsye ekzistojnë prova nga të cilat krijohet dyshimi i arsyeshëm se me veprimet e mësipërme është kryer vepra penale e "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Sa më sipër, duke qenë se disponimi i lirë i shumave monetare dhe pronave të fituara në mënyrë të kundraligjshme nga shtetasit F. V. dhe Shqipëri P. duke patur parasysh se këto pasoja mund të rëndohen, si dhe referuar faktit se mund të cënohen interesat ligjorë të shtetasve ose personave juridikë blerës pontencialë të këtyre pronave, të mbrojtura nga ligji penal apo ligjet e tjera, në mbështetje të neneve 274, 275 të K. Pr Penale duhet të vendoset sekuestro preventive.

#### **Ligji i zbatueshëm:**

Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale: "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153 lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal...".

Neni 276 i Kodit të Procedurës Penale: "1. Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim. 2. Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijani për sekuestron e vënë...".

Neni 36 i Kodit Penal: "1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: ...b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;"

#### **Arsyetimi ligjor:**

Nevojat e procedimit penal, përveç atyre lidhur me lirinë personale, mund të kenë të bëjnë edhe me sendet, në masën që ato mund të prekin apo cënojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e procedimit penal, kur disponimi i lirë i tyre mund të rëndojë, apo të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Nëpërmjet vendimit mbi sekuestrimin preventiv të sendeve, autoriteti gjyqësor synon heqjen/bllokimin e një sendi/apo pasurie të përcaktuar, nga disponimi i lirë i një subjekti që e zotëron atë, duke i vendosur sendit një detyrim të caktuar, i cili mund të jetë me karakter të përkohshëm apo përfundimtar në rastin e veprimtarive të ndaluara me ligj.

Së pari: kërkohet dyshim/provë e veprës penale edhe më e lehtë se ajo e sekuestros konservative, madje pavarësisht nga fajësia apo njohja e autorit të saj. Për qëllim të caktimit të masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive nuk është kusht njohja apo dyshimi në personin që i atribuohet vepra penale dhe përkatësia e pronësisë së sendit. Mund të jetë objekt i sekuestros preventive si sendi që i përket personit që i atribuohet vepra ashtu edhe sendi që i përket një personi të tretë apo të dëmtuarit nga vepra penale.

Në këtë kuadër, Gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale të *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”* e parashikuar nga neni 287 i K.Penal për këto arsye:

- I. Transaksionet e vlerave monetare, në emër të shtetasve P. N. V dhe Sh. P. P dhe familjarëve të tyre, të cilat janë kredituar nga shtetasi suedez S. A. Li me vendbanim në Zvicër, krijojnë dyshime të arsyeshëm se me veprimet e mësipërme është kryer vepra penale e *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”* e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.
- II. Tjetërsimi i fondeve dhe investimi në pasuri të paluajtshme në Shqipëri për llogari të personave të tretë (*jo-rezident*) është e paqartë pse shtetasi suedez S. A. L me vendbanim në Zvicër i transferon nga llogaria e tij personale tek llogaria e S. P në Shqipëri.

Së dyti: Kusht për vendosjen e sekuestros preventive është prania e elementit të *“rrezik/dëm nga vonesa”*. Ky element përbën vetë qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë, pra në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Në këtë mënyrë, elementi nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht.

Sekuestroja preventive mund të urdhërohet për *“qëllime të parandalimit”* të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës “2”, të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për *“qëllime të sekuestrimit”*, sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Objekti i sekuestros preventive, sipas pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga *“sendet që lidhen me veprën penale”*, domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit. Ekziston në këtë rast një lidhje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e sendit me veprën penale dhe objektivisht mundësi e zgjatjes apo rëndimit të pasojave të veprës penale.

Ndërsa në rastin e pikës “2” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal. Së pari, sendi duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale dhe së dyti, është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm.

Nga aktet dhe provat e paraqitura nga prokurori veçanërisht të dhenat identifikuese të transfertës në mbërritje në vlerë 3 849 925 EUR si mëposhtë:

CO = C G  
20: 1  
23B: CRED  
32A: J  
33B: EUR3850000,00  
50K: /CH-40007...  
50K: ST A L  
50K: ROU  
50K: 3963  
52A: 52A:E  
52A: BANQUE CANTONALE DU VALAIS  
59: /ALS22... RV  
59: P.J. OC  
59: LAGJIA SKENDERBEG  
59: 4501 LEZHE

70: GIFT TO MY DEAREST FRIEND P. V rezulton dyshimi i arsyeshëm se keto vlera monetare të cituara në kërkesë nuk janë të justifikuar, për rrjedhim ato përbëjnë produkt të veprës penale, në kuptim të nenit 36/1/b të Kodit Penal. Konkretisht, vlerat monetare rrjedhin dhe janë fituar drejtpërdrejtë nga kryerja e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Në këtë rast produktet e veprës penale janë të tilla që mbartin lidhjen e drejtpërdrejtë dhe rrezikshmërinë e rëndimit të pasojave të veprës penale. Kjo për arsye se për një periudhë kohore të shkurtër menjëherë me mbërritjen e ketyre vlerave monetare, janë kryer terheqje cash dhe blerje të pasurive të paluajtshme. Duke patur parasysh numrin e veprimeve juridike të kryera dhe kohën e kryerjes së tyre, këto vlera monetare dhe prona mund të jenë objekt i veprimeve të mëtejshme të ndryshme juridike duke sjellë kështu si pasojë që të cënohen interesat ligjorë të shtetasve ose personave juridikë të tjerë dhe për rrjedhim rëndimin e pasojave të veprës penale.

Së më sipër gjykata vlerëson se plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në ligj për vendosjen e sekuestros preventive, ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe rezulton se prej veprimeve të kundërligjshme janë fituar pasuri të paluajtshme të cilat përbëjnë produkt të veprës penale, nga disponimi i lirë i të cilave ekziston rreziku për rëndimin e pasojave të veprës penale.

Duke qënë se sekuestro preventive vendoset mbi pasuri dhe depozita bankare në pronësi të personave që u atribuohet vepra penale, duke sjellë kështu kufizim në të drejtën e tyre të pronës dhe vlerave monetare, të garantuar nga neni 41/1 i Kushtetutës dhe neni 1 Prot I i KEDNJ, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ, masa e sekuestros preventive në këtë rast parashikohet në ligj dhe synon vetëm ndalimin e disponimit të lirë të kësaj pasurie dhe vlerave monetare me qëllim mosrëndimin e pasojave të veprës penale, duke plotësuar kështu kriteret e kufizimit të së drejtës së pronës të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ.

#### PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 36 të Kodit Penal dhe nenet 274, 275 dhe 276 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 1 Prot I të KEDNJ,


### VENDOSI

1. Pranimin e kërkeses.
2. Vendosjen e sekuestros preventive mbi;
  - a. Llogarite, transaksionet bankare dhe çdo depozite ne Bankat e nivelit te dyte, Banka Kombetare Tregatre në emër dhe për llogari të shtetasve; P. V. i biri i N. dhe D. i datëlindjes ( me ID nr. ) , lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh P. , e bija e P. dhe P. e datelindjes , me ID nr.G , lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.
  - b. Pasuritë e paluajtshme duke urdheruar sekuestrimin e tyre ne Zyres Vendore te Regjistrimit te pasurive te Paluajtshme Lezhe, Zyres Vendore te Regjistrimit te pasurive te Paluajtshme Tirane, ashtu dhe ne gjendjen faktike ne te cilen ndodhen sot në pronësi të shtetasve; P. V. , i biri i N. e dhe D. i datëlindjes ( lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh P. e bija e P. dhe P. e datelindjes ) lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.
3. Urdherohen Banka Kombetare Tregatre, qe te ndalojne çdo lloj transaksioni bankare ne emer dhe per llogari te shtetasve P. V. i biri i N. dhe D. , i datëlindjes me ID nr. D. L, lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh P. , e bija e P. dhe P. e datelindjes , me ID nr.G lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.
4. Urdherohet Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Lezhe dhe Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane qe te ndaloje shitjen, dhurimin apo çdo lloj disponimi tjeter te pasurive te paluajtshme ne pronësi të shtetasve; P. V. , i biri i N. dhe D. i datëlindjes lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh P. , e bija e P. dhe P. , e datelindjes 9 lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.
5. Urdherohet Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Lezhe dhe Policia Gjyqesore per ekzekutimin dhe zbatimin e ketije vendimi.
6. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder, nga secili person qe ka interes brenda 10 (dhjete) diteve nga dhenia e vendimit ose nga dita qe i interesuari ka marre dijeni per sekuestron e vënë.

U shpall ne Lezhe, sot me 23.01.2019.

SEKRETARE

Diella Ndoci



GJYQTAR

ARTAN HAJREDINAJ






**Shënim:** Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.40, datë 20.02.2019, ka vendosur:  
Lënien në fuqi të vendimit nr.17, datë 23.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.  
Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

KRYESEKRETARE

Ahmedije MARKU



**Shënim:** Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.00-2020-16, datë 08.05.2020, ka vendosur:

Mospranimin e rekursit të ushtruar nga shtetasi P. V i përfaqësuar nga mbrojtësi E (Gj  
(M. ), kundër vendimit nr. @ datë 20.02.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

KRYESEKRETARE

Klaudje MARKU

